



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-018
Prishtinë, më 9 gusht 2021, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 9 GUSHT 2021

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Bedri Hamza, Kujtim Shala dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Ariana Musliu-Shoshi, Arben Gashi dhe Erxhan Galushi.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozimin e kryetarit, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 16, 19, 21, 28 korrik dhe 6 gusht 2021,
3. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 6 gusht 2021,
4. Përgatitjet për seancë të re plenare,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 3 gusht 2021.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 16, 19, 21, 28 korrik dhe 6 gusht 2021

Kryesia vendosi që vazhdimi i seancës plenare të lartshënuar të shtyhet për Sesionin vjeshtor të punimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 6 gusht 2021

Kryesia, pasi diskutoi për pikat e papërfunduara të seancës plenare të lartshënuar, vendosi që vazhdimi i saj të mbahet të enjten, më 12 gusht 2021, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

7. *Votimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare,*
8. *Shqyrtimi i Raportit me rekomandime lidhur me problemet e evidentuara në NP KOSTT Sh.a,*
9. *Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e kryetarit dhe katër (4) anëtarëve të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.*

4. Përgatitjet për seancë të re plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 12 gusht 2021, në orën 10:30, me këtë:

Rend dite

- 1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 2. Pyetjet parlamentare,*
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-024 për ratifikimin e Amendamentit nr.1 të Marrëveshjes të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë hungareze në lidhje me Programin kornizë për bashkëpunim financiar,*
- 4. Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës,*
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2020,*
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2020,*
- 7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2020,*
- 8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2020,*
- 9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2020,*
- 10. Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në komisionin parlamentar.*

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

- 1. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021*

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Administrata e Kuvendit të Kosovës.

- 2. Emërimi i kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të Grupeve të Miqësisë*

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me emërimin e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të Grupeve të Miqësisë, meqenëse nuk ishin paraqitur të gjitha propozimet nga grupet parlamentare, si dhe nuk ishin të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare në mbledhje të Kryesisë, vendosi që emërimi i tyre të shtyhet për ndonjë mbledhje të ardhshme të Kryesisë së Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia e shqyrtoi edhe këtë pikë shtesë:

1. Kërkesa e kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Haki Abazi, lidhur me udhëtimin zyrtar në Austri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 08-V-044 datë 13.07.2021

1. Pika një (1) e Vendimit nr. 08-V-044, datë 13.07.2021, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: “Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Haki Abazi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Austri, prej datës 25 gusht deri më 1 shtator 2021”.

* * *

Në fund, Kryesia diskutoi edhe për përfundimin e Sesionit pranveror të punimeve të Kuvendit, për të cilin kryetari tha se do të jetë data 13 gusht 2021, ndërsa njoftimin do ta bëjë në fund të seancës plenare më 12 gusht 2021.

* * *

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 11:51 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale